



Datë: 03.04.2025
Numër Protokolli: 2374/2025

A.nr.237/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosje e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.237/2025 të datës 29.01.2025 të parashtruar nga ankuesi, B.L, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Pezullim nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.237/2025, e datës 29.01.2025 e parashtruar nga ankuesi B.L.

II. Anulohet Vendimi Ref.02/Nr.324 i datës 06.01.2025, ndërsa **mbetët në fuqi** Vendimi Ref.02/Nr.322 i datës 03.01.2025, i U.D Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III. Obligohet U.D Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta kthejë ankuesin në vendin e tij të punës sipas Akt emërimit të datës 05.12.2012, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, B.L (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 29.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 623/2025, të regjistruar nën shenjën A.nr.237/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.02/Nr.324 të datës 06.01.2025, të U.D Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 19.02.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1627/2025 të datës 12.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 623/2025 të parashtruar nga ankuesi më datë 29.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref.02/Nr.324 të datës 06.01.2025; Vendimin Ref.02/Nr.322 të datës 03.01.2025; Kërkesën me numër protokolli 6417/03 të datës 17.12.2024; Aktgjykimin P.nr.3687/15 të datës 26.09.2024; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 11.12.2024; Vendimin me numër protokolli 1777 të datës 02.11.2015; Vendimin me Nr.02Ref.239 të datës 10.09.2014; Vendimin me Nr.02Ref.234 të datës 09.09.2014; Akt emërimin e datës 05.12.2012; Autorizimin e datës 28.01.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 19.02.2025; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 05.12.2012; Vendimin me Nr.02Ref.304 të datës 04.11.2015; Komunikimet elektronike zyrtare në mes MINT dhe Prokurorisë së Shtetit; Ankesën e datës 12.09.2014; Listat e pagave të ankuesit;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punës tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, sipas Akt emërimit të datës 05.12.2012, përkatësisht në pozitën e punës *Zyrtar i Materialit të Ndërtimit dhe i Shfrytëzimit të Resurseve*, pranë Departamentit të Ndërtimitarisë.

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, fillimisht më datë 09.09.2014, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 956, me të cilin ka pezulluar nga detyra ankuesin me 50% të pagës, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor, me arsyetimin se i njëjti më datë 08.09.2024 e ka kërcënuar verbalisht Sekretaren e Përgjithshme të MTI-së në zyrën e saj, ndërsa më datë 10.09.2024 e njëjta ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 964, duke shfuqizuar vendimin

paraprak ashtu që ankuesin e ka pezulluar nga detyra me pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor, ndërsa sipas pikës II të dispozitivit ishte përcaktuar se ankuesi nuk duhet të vazhdojë punën pranë organin përkatës të punësimit deri në zgjedhjen e rastit nga Komisioni Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i MTI-së, më datë 02.11.2015 ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 1777, ku sipas pikës I të dispozitivit të këtij akti kishte shfuqizuar Vendimin me Nr.02 Ref.239 të datës 10.09.2014 e Sekretares së Përgjithshme, ndërsa sipas II të dispozitivit ishte obliguar Organi përgjegjës për Menaxhimin e Personelit në organin përkatës të punësimit, që ndaj ankuesit të ndërmerre hapat e nevojshëm për pezullim parandalues, në pajtim me dispozitat e nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me arsyetimin se gjatë draftimit të vendimit lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen e rastit përkatës, MTI kishte pranuar njoftim/informacion nga Prokuroria e Shtetit se ndaj ankuesit është iniciuar procedurë penale për shkak të dyshimit për kryerjen e veprës penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, “Kanosje” e përcaktuar sipas nenit 185 paragrafi 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

U.D Sekretari i Përgjithshëm i MTI-së, bazuar në Vendimin e lartë theksuar me numër protokolli 1777 të datës 02.11.2015 të Komisionit Disiplinor si dhe njoftimin e datës 27.10.2015 të Prokurorisë së Shtetit, në mbështetje të nenit 69 të Ligjit Nr.03-L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe paragrafit 3 të nenit 8 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, më datë 04.11.2015 ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 1791, mbi të cilin akt ankuesin e ka pezulluar me 50% të pagës së tij, deri në marrjen vendimit përfundimtar nga Gjykata në procedurën penale.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, në çështjen penale kundër të pandehurit/ankuesit të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinës PP.11,nr,8298/2024, të datës 16.11.2015, për shkak të veprës penale Kanosja e përcaktuar nga neni 185 paragrafi 3 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, më datë 26.09.2024 komfor nenit 362 paragrafit 1 nën paragrafi 1.3 të KPPK-së, ka nxjerrë Aktgjykimin me shifër P.nr.3687/15, mbi të cilin aktgjykim ka refuzuar akuzën ndaj ankuesit për arsye të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, rrjedhimisht ky vendim është bërë i plotfuqishëm me datë 02.12.2024.

Si rrjedhojë, ankuesi më datë 17.12.2024 kishte parashtruar kërkesë numër 6417/03 protokolli tek Zyra e Personelit e Ministrisë, së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, sipas së cilës i njëjti ka kërkuar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e pikës II të dispozitivit të Vendimit me numër protokolli 1777 të datës 02.11.2015, Komisionit Disiplinor të MTI, përkatësisht zbatimin e dispozitave të nenit 69 paragrafit 3 të Ligjit Nr.03-L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, U.D Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë, së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 03.01.2025 ka nxjerrë Vendimin Ref.02/Nr.322, ashtu që ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 1791 të datës 04.11.2015, rrjedhimisht ka kthyer ankuesin në pozitën e mëparshme atë *Zyrtarit të Materialit të Ndërtimit dhe i Shfrytëzimit të Resurseve*, mirëpo e njëjta më datë 06.01.2025 ka nxjerrë Vendimin Ref.02/Nr.324, përmes të cilit akt ka shfuqizuar vendimin e datës 03.01.2025, me

arsyetimin se nuk ka qenë në dijeni se vendimi për pezullim parandalues është marrë si vendim i komisionit të atëhershëm disiplinor.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, përmes përfaqësuesit të autorizuar pretendon se vendimi i lartë theksuar është nxjerrë përmes shkeljeve të ligjit procedural dhe material, si rrjedhojë i njëjti i propozon Këshillit, të aprovohet në tërësi ankesa, të anulohet vendimi kontestues Ref.02/Nr.324 i datës 06.01.2025, të anulohet kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit si dhe të pushohet procedura disiplinore e vitit 2014 e iniciuar ndaj tij, si procedurë e iniciuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ndërsa të mbetet në fuqi Vendimi Ref.02/Nr.322 i datës 03.01.2024 dhe të obligohet Sekretarja e Përgjithshme e MINT në atë mënyre që të plotësojë këtë akt duke shtuar pikën III të dispozitivit, për kompensimin retroaktiv të 50% të pagës së ankuesit nga data 02.11.2015 e deri në plotfuqishmërinë e këtij vendimi.

Kolegji Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me çështjen e pezullimit parandalues, ju referua dispozitave ligjore të aplikueshme për periudhën kohore kontestuese, gjegjësisht nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës se tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjykimit; 1.3. kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet. 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. 3. Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimit.;* rrjedhimisht bazuar në këto dispozita ligjore dhe shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Disiplinor përmes Vendimit me numër protokolli 1777 të datës 02.11.2015, kishte kthyer ligjshmërinë e çështjes përkatëse, sepse MTI-ja kishte pranuar njoftim/informacion nga Prokuroria e Shtetit se ndaj ankuesit është iniciuar procedurë penale për shkak të dyshimit për kryerjen e veprës penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, “Kanosje” e përcaktuar sipas nenit 185 paragrafi 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që kishte obliguar Organin përgjegjës për Menaxhimin e Personelit të ndërmerre hapat e nevojshëm për pezullim parandalues ndaj ankuesit, i cili përmes Vendimit me numër protokolli 1791 të U.D Sekretarit të Përgjithshëm ishte pezulluar me 50% të pagës së tij, deri në marrjen vendimit përfundimtar nga Gjykata në procedurën penale.

Si rrjedhojë e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit me shifër P.nr.3687/15, të datës 26.09.2024, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, mbi të cilin aktgjykim është refuzuar akuza ndaj ankuesit për arsye të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, Kolegji i Këshillit konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të paragrafit 3 të nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që ankuesi të kthehet në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës e themeluar sipas Akt emërimit të datës 05.12.2012, ndërsa Kolegji konstaton se përmes Vendimit Ref.02/Nr.324 i

datës 06.01.2025 nuk është vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe juridike, dhe si i tillë arsyetimi i tij është i pa qëndrueshëm ngase vendimi për pezullim parandalues ndaj ankuesit, siç edhe është theksuar më lartë nuk është marrë nga Komisioni Disiplinor por nga U.D Sekretari i Përgjithshëm, sepse faktikisht ndërmarrja e këtij veprimi kur ndaj nëpunësit civil është iniciuar procedurë penale për kryerjen e veprave penale gjatë ushtrimit të funksionit të tij, nuk ishte kompetencë e Komisionit Disiplinor por e njësisë përkatëse për menaxhimin e personelit, ashtu që ne rastin konkret inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit si dhe nxjerrja e Vendimit me numër protokolli 1777 të datës 02.11.2015, nuk rezulton se ka krijuar pasoja juridike apo thënë më konkretisht shqiptim të masës disiplinore nga Komisioni për ankuesin, mirëpo përmes këtij vendimi Komisioni Disiplinor duke u bazuar në gjendjen faktike kishte kthyer ligjshmërinë e kompetencës dhe vendosjen e çështjes përkatëse.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi Ref. 02/Nr.324 i datës 06.01.2025 i U.D Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmban mangësi të theksuara dhe është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, thënë më konkretisht si për nga elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, përmbajtja ashtu edhe arsyetimi i njëjti akt nuk ka mbështetje në dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafit 1.4 dhe nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 dhe 1.3 të këtij ligji, ngase nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, ashtu që i njëjti akt është në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të këtij neni, i cili përcakton se: “2. *Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*” dhe si i tillë konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për rrjedhojë i njëjti është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa është lënë fuqi Vendimi Ref.02/Nr.322 i datës 03.01.2025, i U.D Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me obligimin ligjor që kjo e fundit duke u bazuar në dispozitat e aplikueshme ligjore të periudhës konkrete, të kthejë në punë ankuesin me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij sipas Akt emërimit të datës 02.11.2015.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.237/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokat Hajzer Salihu;
- Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (U.D Sekretares së Përgjithshme dhe U.D Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.